



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 960/1 prot.

Tiranë, më 24/09 /2020

**URDHËR**

Nr. 124, datë 24.09.2020

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E FORMËS SË REGJISTRIT DHE MËNYRËN E MBAJTJES  
DHE RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE STATISTIKORE TË ÇËSHTJEVE ME TË  
MITUR, NË PROKURORITË PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË  
ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 38 pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”,

**URDHËROJ:**

Neni 1

**Regjistri i çështjeve me të mitur**

1. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, të krijohet regjistri i veçantë për regjistrimin e çështjeve me të mitur, sipas modelit Aneks 1 bashkëlidhur këtij urdhri, i cili bëhet pjesë e regjistrave që administrohen nga zyra e regjistrit.
2. Për mbajtjen e regjistrit manual dhe elektronik, në prokuroritë ku ka seksione për të miturit, ngarkohet drejtuesi i seksionit, ndërsa në prokuroritë ku nuk ka seksione për të mitur, ngarkohet njëri nga prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve me të mitur. Drejtuesi i seksionit/prokurori i caktuar, asistohet nga punonjësi i ngarkuar me punën me regjistrat në atë prokurori.

## Neni 2

### **Administrimi i regjistrit**

1. Për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e regjistrit zbatohen rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat, që mbikëqyret nga përgjegjësi i zyrës së regjistrit.
2. Përdorimi dhe aksesimi i të dhënave të të miturit që mbahen në regjistër kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Gabimet në regjistër korrigjohen me një vijë të drejtë me stilolaps të thjeshtë mbi tekstin e regjistruar gabimisht, duke siguruar që teksti të mbetet i lexueshëm. Informacioni i saktë më pas shënohet në po atë fushë pa mbuluar tekstin që përmban gabimin.
4. Regjistri mbyllet në fund të vitit kalendarik. Për procedimet e mbartura, të dhënat në lidhje me ecurinë e procedimit pasqyrohen në rubrikat e paplotësuara të të njëjtit regjistër. Mbyllja e librave të regjistrimit bëhet në atë mënyrë që në mbarim të vitit, në numrin e fundit të lëndës së regjistruar, futet një shënim që përmban: datën, muajin, vitin e mbylljes së regjistrit, numrin serik të lëndës së fundit të regjistruar për atë vit dhe numrin e lëndëve të papërfunduara në fund të vitit.

## Neni 3

### **Mbajtja dhe raportimi i evidencës statistikore**

1. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të mbajnë të dhënat statistikore për të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit viktimë të veprës penale, për periudha 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, sipas modelit Ankes 2, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore, në prokuroritë ku ka seksione për të miturit ngarkohet një oficer i policisë gjyqësore i seksionit, ndërsa në prokuroritë ku nuk ka seksione për të mitur, ngarkohet një oficer i policisë gjyqësore i caktuar me hetimin e procedimeve penale me të mitur. Oficeri i policisë gjyqësore, asistohet nga punonjësi i ngarkuar me mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në atë prokurori.
3. Të dhënat nxirren nga regjistri i veçantë i çështjeve me të mitur dhe rakordohen periodikisht edhe me prokurorët që ndjekin çështje me të mitur.
4. Procesi i mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore për të miturit, mbikëqyret nga drejtuesi i seksionit/prokurori i ngarkuar me hetimin e çështjeve me të mitur.
5. Brenda datës 10, të muajve janar, prill, korrik e tetor, përkatësisht për periudhat vjetore, 3-mujore, 6-mujore dhe 9-mujore, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të depozitojnë në strukturën përgjegjëse për statistikën në Prokurorinë e Përgjithshme, me email dhe shkresë zyrtare, evidencën me të dhënat statistikore.

6. Evidenca të shoqërohet me një relacion/analizë të hollësishme për punën mujore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore të prokurorisë në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
7. Punonjësit e ngarkuar me mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në atë prokurori dhe struktura/punonjësit përgjegjës për statistikat në Prokurorinë e Përgjithshme, gjatë hedhjes dhe përpunimit në formë elektronike të të dhënave statistikore, duhet të verifikojë dhe kontrollojë saktësinë matematikore të tyre, duke bërë rakordimin e kryqëzuar të të dhënave dhe treguesve statistikorë dhe përsa është e mundur edhe vlerësimin logjik të tyre. Për çdo problem/shkelje të konstatuar, informojnë drejtuesit përkatës.

#### Neni 4

#### **Mënyra e plotësimit të statistikave**

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, në plotësimin e të dhënave statistikore, të respektohen rregullat si më poshtë:
  - i. Çështjet dhe treguesit vijues do të evidentohen sipas paragrafëve të neneve të Kodit Penal;
  - ii. Kur çështja është regjistruar për dy ose më shume vepra penale, atëherë çështja do të evidentohet për veprën penale qe përmban akuzën më të rëndë;
  - iii. Kur çështja ka disa të pandehur që akuzohen për vepra penale të ndryshme, evidentimi i saj do të bëhet për veprën penale më të rëndë, duke pasqyruar dhe numrin e të pandehurve dhe të arrestuarve për akuzën më të rëndë, ndërsa numri i të pandehurve të tjerë do të regjistrohet vetëm për veprën penale që ata akuzohen, pa u shënuar si çështje më vete.
2. Kuadrimet kryesore që duhet të përmbushë formulari, janë si më poshtë:
  - i) Të dhënat lidhur me zbatimin e masës së shmangies, si në rastin e mosfillimit ashtu edhe të pushimit, duhet të rezultojnë si shumë e masave alternative të parashikuara nga neni 62/a i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
  - ii) Në rubrikat “çështje të mosfilluara” dhe “çështje të pushuara” duhet të bëhet pasqyrim i saktë dhe në kolona më vete i çështjeve të mosfilluara dhe të pushuara për shkak të aplikimit të masës së “shmangies”, sipas alternativave të parashikuara nga neni 62 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, dhe çështjeve të mosfilluara dhe pushuara për shkaqe të tjera, parashikuar nga nenet 290 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale;
  - iii) Të dhënat për të pandehurin: “Gjinia”, “Grupmosha”, “Përsëritës” dhe “Shtetësia”, duhet të jenë të barabarta midis tyre në total, në mënyrë që ata të pandehur që janë detajuar sipas gjinisë të jenë të barabartë me ata të detajuar sipas grup moshës, etj., si dhe totali i tyre të jetë i barabartë me totalin e të pandehurve dhe personave nën hetim regjistruar;

- iv) Të dhënat lidhur me referimet në parim duhet të jenë *barabartë ose më e vogël* se shuma e mosfillimeve dhe çështjeve të regjistruara. Në rast mospërputhje, shkak të evidentohet me një shënim në fund të tabelës;
- v) Të dhënat lidhur me kërkesën e prokurorit për dënim dhe vendimin e gjykatës për dënim, duhet të jenë barabarta. Në rast mospërputhje, shkak të evidentohet me një shënim në fund të tabelës;
- vi) Kuadrimi i rreshtave (paragrafëve, neneve, seksioneve, krerëve dhe totalit), bëhet nëpërmjet formulave të shumave, siç janë hedhur në CD bashkëlidhur.

#### Neni 5

### Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër, kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore sipas ligjit dhe këtij urdhri dhe shkak për nisjen e verifikimeve nga Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe/ose hetimit disiplinor.

#### Neni 6

### Dispozita të fundit dhe zbatuese

1. Për të individualizuar çështjet ku përfshihen të mitur, në regjistrin e procedimeve penale, në çështjet me autor të mitur, pas numrit të procedimit të shënohet “PM” dhe në çështjet me viktima të mitur pas numrit të procedimit të shënohet “VM”.
2. Pas hapjes së dosjes penale, do të plotësohet në vijimësi Kartela sipas ankesit 3 bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, drejtuesit e seksioneve për të miturit, prokurori i ngarkuar me hetimin e çështjeve penale me të mitur në prokuroritë ku nuk ka seksione për të mitur, oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për mbajtjen e të dhënave statistikore për të mitur, zyra e regjistrit dhe punonjësit përkatës të administratës.
4. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij urdhri ngarkohen drejtuesit e prokurorive dhe drejtuesit e seksioneve për të mitur në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, struktura/punonjësit përgjegjës për statistikën dhe Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

